



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 61, datë 24 .12. 2012

PËR

**“NJË NDRYSHIM NË RRJETIN E LINJAVE QYTETASE TË TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.25, DATË 16.05.2006 MBI “PËRCAKTIMIN E LINJAVE TË TRANSPORTIT QYTETËS TË UDHËTARËVE, MËNYRËN E ORGANIZIMIT TË SHËRBIMIT DHE RIPËRCAKTIMI I STACIONEVE TË QËNDRIMIT TË AUTOBUSËVE TË SHËRBIMIT NË KËTO LINJA”(I NDRYSHUAR)”**

Në zbatim të nenit 10/3/I, shkronja “d” dhe nenit 32, shkronja “k” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 128, të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (i ndryshuar); ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); nenit 14 të ligjit nr.8308, datë 18.03.1998 për “Transportet Rrugore” (i ndryshuar); udhëzimit nr.15, datë 24.7.2007 për “Kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit Bashkiak nr.25, datë 16.05.2006 mbi “Përcaktimin e linjave të transportit qytetës të udhëtarëve, mënyrën e organizimit të shërbimit dhe ripërcaktimi i stacioneve të qëndrimit të autobusëve të shërbimit në këto linja” (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Ndryshimin e paragrafit të 1-rë, të pikës 2, të vendimit të Këshillit Bashkiak nr.25, datë 16.05.2006 mbi “Përcaktimin e linjave të transportit qytetas të udhëtarëve, mënyrën e organizimit të shërbimit dhe ripërcaktimi i stacioneve të qëndrimit të autobusëve të shërbimit në këto linja”(i ndryshuar) , *Linja nr. 1 “Kombinat – Qendër – Kinostudio”* nga linjë me 19 stacione në linjë me 21 stacione, me përmbajtje si më poshtë:

***Linja Nr.1 “Kombinat – Qendër – Kinostudio”.***

Fillon në kombinat në afërsi të lulishtes tek “Sheshi Garibaldi” (stacioni i nisjes), kalon në rrugën “Konferenca e Pezës”, vazhdon në rrugën e “Kavajës” deri në kryqëzimin me Blv. “Dëshmorët e Kombit”, vazhdon në rrugën “Abdi Toptani” deri në kryqëzimin me rrugën “George W. Bush”, kalon përgjatë saj dhe rrugës së “Barikadave” deri në kryqëzimin me rrugën “Dibrës”, ecën përgjatë rrugës “Aleksandër Moisiu” duke u pozicionuar në stacionin fundor pranë Kinostudios.

Kthimi është në të njëjtën rrugë me ndryshimin e intenerarit nga rruga e “Dibrës” kalon në Blv. “Dëshmorët e Kombit” dhe kthehet në rrugën e “Kavajës” duke ndjekur intenerarin për në stacionin fundor.

Shërbimi i transportit qytetës në këtë linjë duhet të plotësojë këta tregues:

#### A. Frekuencat

Frekuenca për linjën	F = 3 min
Frekuenca e daljes nga stacioni i nisjes në qëndër:	F = 3 min
Numri i autobusëve në lëvizje:	Is = 30 bus
Numri i autobusëve në inventar për linjën:	I = 36 bus
Koha për një cikël nisje/mbërritje:	Tc = 71 min = 1.2 orë
Gjatësia e linjës:	18 km
Kapaciteti mbartës i autobusëve:	C = 90 vende (25 ndenjor dhe 65 në këmbë)

#### B. Oraret

A. Oraret për shërbimin e transportit në linjë do të jenë:

- Në periudhën **Prill – Tetor**, orari i shërbimit do të jetë nga ora **05:00** deri në orën **24:00** me frekuencën si më poshtë:

Nga ora 5. <sup>00</sup> deri në ora 6. <sup>00</sup> ,	frekuenca do të jetë 8 minuta
Nga ora 6. <sup>00</sup> deri në ora 7. <sup>00</sup> ,	frekuenca do të jetë 6 minuta
Nga ora 7. <sup>00</sup> deri në ora 9. <sup>00</sup> ,	frekuenca do të jetë 3 minuta
Nga ora 9. <sup>00</sup> deri në ora 15. <sup>00</sup> ,	frekuenca do të jetë 5 minuta
Nga ora 15. <sup>00</sup> deri në ora 17. <sup>00</sup> ,	frekuenca do të jetë 3 minuta
Nga ora 17. <sup>00</sup> deri në ora 20. <sup>00</sup> ,	frekuenca do të jetë 6 minuta
Nga ora 20. <sup>00</sup> deri në ora 22. <sup>00</sup> ,	frekuenca do të jetë 7 minuta
Nga ora 22. <sup>00</sup> deri në ora 24. <sup>00</sup> ,	frekuenca do të jetë 10 minuta

Stacioni i fillimit: Kombinat, në afërsi të “Sheshit Garibaldi” në ora **5:00**  
Stacioni fundit: Kinostudio ora **23.30** niset autobusi i fundit.

- Në periudhën **Nëntor–Mars**, orari shërbimit do të jetë nga ora **05.30** deri në orën **23.30** me frekuencën si më poshtë:

Nga ora 5. <sup>30</sup> deri në ora 6. <sup>00</sup> ,	frekuenca do të jetë 8 minuta
Nga ora 6. <sup>00</sup> deri në ora 7. <sup>00</sup> ,	frekuenca do të jetë 6 minuta
Nga ora 7. <sup>00</sup> deri në ora 9. <sup>00</sup> ,	frekuenca do të jetë 3 minuta
Nga ora 9. <sup>00</sup> deri në ora 15. <sup>00</sup> ,	frekuenca do të jetë 5 minuta
Nga ora 15. <sup>00</sup> deri në ora 17. <sup>00</sup> ,	frekuenca do të jetë 3 minuta
Nga ora 17. <sup>00</sup> deri në ora 20. <sup>00</sup> ,	frekuenca do të jetë 6 minuta
Nga ora 20. <sup>00</sup> deri në ora 22. <sup>00</sup> ,	frekuenca do të jetë 7 minuta
Nga ora 22. <sup>00</sup> deri në ora 23. <sup>30</sup> ,	frekuenca do të jetë 10 minuta

Stacioni i fillimit: Kombinat, në afërsi të “Sheshit Garibaldi” në ora **5:30**  
Stacioni fundit: Kinostudio ora **23.00** niset autobusi i fundit.

- **Në ditë të diele dhe festa zyrtare**, orari shërbimit do të jetë nga ora **05.30** deri në orën **23.00** me frekuencën si më poshtë:

Nga ora 5.<sup>30</sup> deri në ora 6.<sup>00</sup>, frekuenca do të jetë 9 minuta  
Nga ora 6.<sup>00</sup> deri në ora 7.<sup>00</sup>, frekuenca do të jetë 6 minuta  
Nga ora 7.<sup>00</sup> deri në ora 20.<sup>00</sup>, frekuenca do të jetë 5 minuta  
Nga ora 20.<sup>00</sup> deri në ora 22.<sup>00</sup>, frekuenca do të jetë 9 minuta  
Nga ora 22.<sup>00</sup> deri në ora 23.<sup>00</sup>, frekuenca do të jetë 10 minuta

Stacioni i fillimit: Kombinatat, në afërsi të "Sheshit Garibaldi" në ora **5:30**  
Stacioni fundit: Kinostudio ora **23.00** nisjet autobusi i fundit.

Kohë qëndrimi në stacionet ndërmjetëse: 30 sekonda.

**C. Kushtet që duhet të plotësojë secili autobus i linjës:**

1. Për automjetet e reja nuk është kusht që duhet të jenë të prodhuara vetëm në vendet e Bashkimit Europian.
2. 100 % i mjeteve të inventarit do të jenë të pajisura me kondicionim.
3. Estetika e jashtme e mjeteve do të jetë 100 %.
4. Estetika e brendshme e mjeteve do të jetë 100 %.
5. 100 % e totalit të inventarit të mjeteve, do të jenë të pajisura me pajisje të veçanta për invalidët.
6. Inventari i mjeteve do të pajiset me platformë të sheshtë 100%.

**D. Stacionet e ndalimit**

Stacionet e ndalimit të autobusit për linjën do të jenë:

Stacioni Nr.1 është "Sheshi Garibaldi" (Stacioni Fillestar).

Stacioni Nr.2 është tek pallatet në dalje të Kombinatit.

Stacioni Nr.3 është në rrugën e "Kavajës", tek kryqëzimi me rrugën "H.Qullhaj".

Stacioni Nr.4 është në rrugën e "Kavajës", tek "Ish Kombinati i Drurit Misto Mame".

Stacioni Nr.5 është në rrugën e "Kavajës", përballë "Fabrikës së Birrës".

Stacioni Nr.6 është në rrugën e "Kavajës", tek "Shkolla Teknologjike".

Stacioni Nr.7 është në rrugën e "Kavajës", tek "Ish Parku i Vjetër".

Stacioni Nr.8 është në rrugën e "Kavajës", tek hyrja e rrugës "Irfan Tomini".

Stacioni Nr.9 është në rrugën e "Kavajës", në afërsi të kryqëzimit "21 Dhjetori" përpara "Poliklinikës së lagjes".

Stacioni Nr.10 është në rrugën e "Kavajës", tek "Kisha Katolike".

Stacioni Nr.11 është në rrugën e "Kavajës", qendër tek lulishtja afër "Bankës së Shqipërisë".

Stacioni Nr.12 është përpara pallateve "9-të katëshe".

Stacioni Nr.13 është në rrugën e "Dibrës", tek "Selvija".

Stacioni Nr.14 është në rrugën e "Dibrës", tek "Medreseja".

Stacioni Nr.15 është në rrugën e "Dibrës", përpara "Konviktit të Mjeksisë".

Stacioni Nr.16 është në rrugën e "Dibrës", përpara "Fakultetit të Mjeksisë".

Stacioni Nr.17 është në rrugën e "Dibrës", tek "Shkolla Ushtarake".

Stacioni Nr.18 është në rrugën e "Dibrës", tek "Rruga - Ura".

Stacioni Nr.19 është në rrugën e "Dibrës", tek sheshi pranë karburantit përballë "Ish Kinostudios Shqipëria Re" (Stacioni fundor).

**Në kthim:**

Stacioni Nr.11/1 është në rrugën e "Kavajës", pranë Dhomës së Tregëtisë.

Stacioni Nr.12/1 është në afërsi të kryqëzimit me rrugën "Bardhok Biba".

2. Ofrimi i këtij shërbimi t'i nënshtrohet procedurave të përzgjedhjes së operatorit privat në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Shërbimi në këtë linjë, deri në përfundimin e procedurave për përzgjedhjen e operatorit të ri, do të ofrohet nga Parku i Transportit Urban të Udhëtarëve.
4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve (Drejtoria e Transportit dhe Lëvizshmërisë), Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (QLT), Drejtoria e Përgjithshme nr.2 e Punëtorëve të Qytetit dhe Agjensia e Mbrojtjes së Konsumatorit, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**Niazi KOSOVRASTI**